



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS
KOMISIONI KONKURENCËS

Nr. 664/prot.
7

Tiranë, më 27.12.2022

VENDIM

Nr. 939 Datë 27.12.2022

“MBI AUTORIZIMIN E PËRQENDRIMIT TË REALIZUAR NËPËRMJET PËRFTIMIT TË KONTROLLIT TË SHOQËRISË MACRO LABELLING S.R.L NGA SHOQËRIA SIDEL PARTICIPATIONS SAS.”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Znj.	Adriana BERBERI	Anëtar
Znj.	Rezana KONOMI	Anëtar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 27. 12. 2022, shqyrtoi çështjen me:

Objekti: Autorizimi i përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Makro Labelling S.r.l. nga shoqëria Sidel Participations SAS.

Baza Ligjore: Nenet 2, 10-12, neni 24, germa d, dhe nenet 53-64 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”; Rregullorja “Për zbatimin e procedurave të përqendrimit të ndërmarrjeve”; Udhëzimi “Për formën e njoftimit të përqendrimit” dhe Formulari i njoftimit të përqendrimit.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm si dhe raportit të Drejtorisë së Analizës dhe Metodologjisë së Tregjeve, mbi njoftimin e përqendrimit të realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Makro Labelling S.r.l. nga shoqëria Sidel Participations SAS.

VËREN SE :

I. Palët në transaksion dhe procedura

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është depozituar njoftimi mbi përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfimit të kontrollit të shoqërisë Makro Labelling S.r.l. nga shoqëria Sidel Participations SAS.

Referuar dokumentit “Marrëveshje e propozuar për shit-blerje kuotash”, datë 27 tetor 2022, palët

Blerësi: Sidel Participations SAS është një shoqëri aksionare, e themeluar sipas ligjeve të Francës. Veprimtaria kryesore përfshin të gjitha operacionet e biznesit të ndërmarrjeve ose të tjera, që kanë të bëjnë në përgjithësi në mënyrë direkte ose indirekte me industrinë metalurgjike, në ndërtime elektrike, elektronike dhe mekanike të industrisë së materialeve plastike.

Sidel Participations është pjesë e Tetra Naval Group, një grup ndërkombëtar shoqërisht private, i përbërë nga 3 grupe të industrisë: Tetra Pak, Sidel dhe DeLaval, të gjitha të fokusuara në teknologjitë për prodhimin, paketimin dhe shpërndarjen efikase të ushqimit dhe pijeve.

Asnjë nga shoqëritë e Grupit nuk ka ndonjë filial në Shqipëri, por grupi është aktiv nëpërmjet shitjeve direkte për klientët në tre sektorët e përmendur më sipër.

Shitësit: Z. Marco Bellini, Z. Stefano Ghizzi, Z. Luca Lavarini, Z. Massimo Manzotti dhe Z. Simone Marcantoni, persona fizik, shtetas të huaj.

Shoqëria Target: Makro Labelling S.r.l., është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar sipas legjislacionit të Italisë. Makro Labelling S.r.l., është e angazhuar, drejtpërdrejt dhe së bashku me filialin e saj tërësisht në pronësi, Marko Labeling UK Limited, një shoqëri e themeluar sipas legjislacionit Anglez dhe Uellsit, në aktivitetin e prodhimit të makinerive industriale të etiketimit për sektorët e pijeve, ushqimit, shtëpisë dhe kujdesit personal dhe industrisë farmaceutike.

Target nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri, megjithatë gjeneron të ardhura shumë të kufizuara në Shqipëri.

II. Përqendrimi

Ndërmjet shoqërisë Sidel Participations SAS (blerësi) dhe personave fizikë Z. Marco Bellini, Z. Stefano Ghizzi, Z. Luca Lavarini, Z. Massimo Manzotti dhe Z. Simone Mercantoni (shitësit) është lidhur “Marrëveshje e propozuar për shit-blerje kuotash”, datë 27 tetor 2022.

Blerësi dhe Shitësit ekzekutuan një ofertë paraprake jo detyruese të datës 31 maj 2022, në të cilën palët përcaktuan kushtet kryesore të blerjes së mundshme nga blerësi të shoqërive Makro Labelling S.r.l. dhe Marko Labeling UK Limited nga shitësit.

Në vijim të diskutimeve dhe negociatave, palët ranë dakord dhe nënshtruan, në lidhje me marrëveshjen e propozuar për shit-blerje kuotash.

Çdo shitës zotëron një kuotë në kapitalin e shoqërisë Makro Labelling S.r.l. e barabartë me 20% të kapitalit të shoqërisë dhe pas mbylljes së marrëveshjes, në përputhje me kushtet dhe termat e saj, çdo shitës do të bëhet një punonjës i shoqërisë në përputhje me marrëveshjet përkatëse të punës. Blerësi është i interesuar të blejë të gjithë kapitalin e shoqërisë Makro Labelling S.r.l. nga shitësit.

Në përfundim të transaksionit, shoqëria Sidel Participations SAS do të zotërojë 100% shoqërinë target Makro Labelling S.r.l.

Transaksioni është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të ligjit nr 9121 datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe si i tillë është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

III. Vlerësimi i konkurrencës

Referuar nenit 3, pika 7, të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, si edhe Udhëzimit nr.76, datë 07.04.2008 “Për përcaktimin e tregut përkatës”, treg përkatës do të konsiderohet tregu i prodhimit të etiketave me shpejtësi të ulët dhe të mesme për industrinë e paketimit, por duke qenë se transaksioni nuk do të ketë asnjë ndikim në tregun shqiptar, tregu përkatës i produktit do të lihet i hapur. Treg përkatës gjeografik do të konsiderohet territori i Republikës së Shqipërisë.

Transaksioni i propozuar është përfitimi i kontrollit të shoqërisë Makro Labeling S.r.l. nga shoqëria Sidel Participations SAS, pjesë e Tetra Laval Group, një grup ndërkombëtar shoqëri private, të fokusuar në teknologjinë për prodhimin, paketimin dhe shpërndarjen efikase të ushqimit dhe pijeve. Sidel ose më gjerë Tetra Laval Group nuk kanë ndonjë filial në Shqipëri, por grupi është aktiv nëpërmjet shitjeve direkte për klientët në tre sektorët e përmendur më sipër.

Makro Labelling Group nuk ka filiale, degë apo zyra përfaqësimi në Shqipëri, megjithatë gjeneron të ardhura shumë të kufizuara në Shqipëri.

Përqendrimi nuk do të krijojë mbivendosje ose marrëdhënie të rrjedhës së sipërme apo të poshtme midis aktiviteteve të palëve në nivel kombëtar dhe për këto arsye, transaksioni i synuar nuk do të sjellë ndryshim dhe nuk do të ketë ndikim në tregun shqiptar.

PËR KËTO ARSYE:

Komisioni i Konkurrencës, në bazë të nenit 24, shkronja d dhe nenit 56 pika 1 të ligjit nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”,

VENDOSI:

1. Të autorizojë përqendrimin e realizuar nëpërmjet përfitimit të kontrollit të shoqërisë Makro Labeling S.r.l. nga shoqëria Sidel Participations SAS.
2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për njoftimin e palëve dhe dërgimin e vendimit pasi të bëhen pagesat që parashikon rregullorja “Për caktimin e shpenzimeve për ndjekjen e procedurave pranë Autoritetit të Konkurrencës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS


Leida MATJA


Zv/Kryetar

Rezana KONOMI


Anëtar

Adriana BERBERI


Anëtar

Durim KRAJA


Anëtar

Denar BIBA


Kryetar

Kryetar